



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

MINISTRI

2988
Nr. Prot.

Tiranë, më 24.03.2017

LËNDA: Shpallja e interesit për trajnimin e punonjësve arsimorë në arsimin parauniversitar për periudhën 2017-2020

DREJTUAR: Subjekteve të interesuara

TIRANË

Të nderuar,

Ju bëjmë me dije se KAPT me vendimin Nr. 2, datë 17 Mars 2017 ka miratuar shpalljen e interesit për subjektet e interesuara sipas tekstit bashkëlidhur.

Faleminderit për mirëkuptimin,

LINDITA NIKOLLA

MINISTER





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

Nr. 2988/1 Prot.

Tiranë, më 24.03.2017

**SHPLLJA E INTERESIT
PËR TRAJNIMIN E PUNONJËSVE ARSIMORË NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR PËR PERIUdhËN 2017-2020**

Bazuar në Udhëzimin nr.1, datë 20.01.2017 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për zhvillimin profesional të punonjësve arsimorë”, Ministria e Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Arsimit, nisur nga prioritetet për të zbatuar kurrikulën e reformuar bazuar në kompetenca, si dhe bazuar në rezultatet e raportit “Identifikimi i nevojave për trajnim i punonjësve arsimorë”, kanë hartuar dokumentin “Shpallja e interesit për trajnim të punonjësve arsimorë”. Për ta bërë sa më gjithëpërfshirës këtë proces është marrë mendimi i shumë aktorëve që kontribuojnë në sistemin arsimor. Ky dokument është bazuar edhe në rekomandime për zhvillim profesional të punonjësve arsimorë, të mbledhura nga politika kombëtare të Drejtorisë së Arsimit Parauniversitar në MAS si dhe analiza e gjetje të kryera nga IZHA, AKP, ISHA, agjenci trajnuese etj.

Shqipëria, si shumë shtete të tjera, ka ndryshuar kurrikulën në sistemin arsimor, e cila ka në bazë ndërtimin e kompetencave për të nxënë gjatë gjithë jetës. Thelbi i kësaj qasje është ndërtimi i njohurive të reja nëpërmjet kompetencave individuale të çdo nxënësi dhe eksperiencës së tij. Në praktikë, kjo do të thotë që çdo nxënës duhet të marrë vëmendje individuale, detyra të personalizuara dhe mundësi për të rikrijuar procesin e tij të të nxënit. “Mëso duke bërë” është fokusi i kësaj qasje në ndryshim nga mësimdhënia tradicionale ku mësuesit transferojnë njohuritë e tyre në mënyrë të njëjtë te të gjithë nxënësit. Njohuritë, aftësitë që zotëron mësuesi, angazhimi e përkushtimi i tij, si dhe cilësia e drejtimit të shkollës janë faktorët më të rëndësishëm në arritjen e rezultateve të larta në sistemin arsimor.

Mësimdhënia cilësore dhe aftësia e mësuesve për të motivuar dhe frymëzuar të gjithë nxënësit që të arrijnë më të mirën e tyre, ka ndikim pozitiv dhe të qëndrueshëm në të ardhmen e fëmijëve dhe të rinjve.

Për këtë arsye është thelbësore që, mësuesit jo vetëm të kenë arsimimin e përshtatshëm dhe përgatitje të lartë profesionale gjatë formimit fillestar të tyre por, për të përmbushur sa më mirë detyrat, duhet të sigurojnë standard të lartë të zhvillimit të vazhduar profesional në të gjitha nivelet.

Ky dokument i adresohet:

- *Institucioneve të Arsimit të Lartë që përgatisin mësues;*
- *IZHA-s; AKP-së; ISHA-s;*
- *DAR/ZA-ve dhe institucioneve arsimore;*
- *Agjencive trajnuese;*
- *Punonjësve arsimorë.*

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur, sipas prioriteteve, fushat dhe çështjet kryesore të identifikuar si nevoja për zhvillimin profesional të personelit arsimor, për periudhën 2017-2020.

FUSHAT	PROGRAME/MODULE TRAJNIMI QË LIDHEN ME ÇËSHTJE KRYESORE PËR ZHVILLIM PROFESIONAL
<p>PLANIFIKIMI I KURRIKULËS</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Dokumentet kurrikulare me bazë kompetencat dhe risitë në programet e fushave/lëndëve (korniza kurrikulare, kurrikula bërthamë, programet lëndore) - Zhvillimi i kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës, duke filluar nga arsimi parashkollor. - Planifikimi i kurrikulës (planifikimi vjetor, planifikimi 3-mujor, planifikimi i orës së mësimit) - Planifikimi sipas nevojave të nxënësit (nxënës me nevoja të veçanta). - Hartimi i planit individual të edukimit (PEI), për nxënës me AK.

MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

- Situata e të nxënit, rezultatet e të nxënit, burimet e të nxënit dhe planifikimi i tyre
- Trajtime të përmbajtjes shkencore sipas fushave/lëndëve
- Projektet kurrikulare lëndore dhe ndërlëndore
- Dosja (portofoli) i nxënësit
- Mësimdhënia dhe të nxënit bazuar në kompetenca
- Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar
- Metodatat e mësimdhënies dhe nxënies me në qendër nxënësin
- Planifikimi dhe trajtimi i situatave të të nxënit.
- Korniza e vlerësimit të nxënësve (çfarë, kur dhe si do vlerësojmë)
- Vlerësimi për të nxënë (instrumentet e vlerësimit, evidencat e vëzhgimeve, vlerësimi diagnostikues, vetvlerësimi i nxënësve)
- Vlerësimi i të nxënit (përpunimi i evidencave; vlerësimi i dosjes së nxënësit)
- Raportimi i progresit dhe arritjeve të nxënësve (format e raportimit)
- Hartimi i testeve formuese, hartimi i testeve përmbledhëse
- Nivelet e arritjes së kompetencave
- Programi për vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve – PISA (Aftësimi i nxënësve në lexim-shkrim, matematikë dhe shkencë dhe metodologjia që përdor PISA për të matur arritjet e nxënësve).
- Metodatat e mësimdhënies dhe nxënies për nxënës me nevoja të veçanta
- Vlerësimi i të nxënit të nxënësve që trajtohen me PEI.
- Metodologji të përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e përgjithshëm
- Mësimdhënia në klasat e bashkuara dhe puna me nivele të ndryshme nxënësish
- Zhvillimi i moduleve kurrikulare në gjimnaz

<p>ETIKA, KOMUNIKIMI DHE PEDAGOGJIA</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kodi i etikës - Komunikimi me nxënësit. Zhvillimi moshor i fëmijëve dhe të rinjve - Motivimi i nxënësve dhe nxitja e iniciativës dhe krijimtarisë - Menaxhimi i klasës dhe konflikteve - Krijimi i ambienteve miqësore për fëmijët me AK ne klasa gjithëpërfshirëse. - Aftësitë sociale dhe të punuarit në ekip. Komunikimi me kolegët. - Roli i psikologut dhe punonjësit social në shkollë. - Komunikimi me prindërit dhe bashkëpunimi me komunitetin. Shkolla qendër komunitare
<p>DREJTIMI I SHKOLLËS¹ DHE ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSUESVE</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Drejtuesi si lider pedagogjik dhe menaxher i personelit mësimor - Strukturat organizative e shkollës dhe menaxhimi i kurrikulës - Menaxhimi i burimeve materiale dhe financiare të shkollës - Planifikimi për zhvillimin e institucionit arsimor - Etika, komunikimi dhe bashkëpunimi me komunitetin - Sistemi i vlerësimit të performancës së drejtorit të shkollës - Zhvillimi i brendshëm profesional i mësuesit dhe pjesëmarrja në aktivitete për zhvillim profesional - Pjesëmarrja në rrjete profesionale dhe ndërveprimi me aktorët e tjerë - Formimi i trajnerëve lidhur me risitë kurrikulare - Standardet e mësuesit, standardet e drejtuesit. - Roli i mentorit dhe zhvillimi i praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit - Përdorimi i TIK në mësimdhënie – nxënie

¹ Sipas programi për “Formimin e drejtuesve të institucioneve arsimore në arsimin parauniversitar”

TIK NË MËSIMDHËNIE – NXËNIE	<ul style="list-style-type: none"> - Përdorimi i pajisjeve DEMO në klasë dhe lëndë të ndryshme - Përdorimi praktik i laboratorit virtual në klasë - Përdorimi i CD-ve dhe metodave interaktive - Mirëmbajtja e rrjetit kompjuterik në shkolla
ÇËSHTJE NDËRKURRIKULARE	<ul style="list-style-type: none"> - Mjedisi - Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave. - Bashkëjetesa paqësore - Të drejtat e njeriut - Të nxënit për sipërmarrje përmes kurrikulës shkollore - Zhvillimi i qëndrueshëm - Arsimi gjithëpërfshirës